

TEKNOLOGJI NË BIZNES - VITI I TRETË- SEMESTRI V

Metodologjia e Zhvillimit te Sistemit te Informacionit (O): 7 ECTS

Kjo lëndë ka për qëllim që studentët të fillojnë me gjërat bazike të metodologjive për zhvillimin e një sistemi të informacionit. Pastaj do të paraqiten disa metodologji dhe teknika më të avancuara, që përdoren në strukturimin, planifikimin dhe kontrollin e proceseve të zhvillimit të këtij sistemi. Do të njoftohen për së afërmi me ciklin e punës/(life cycle), për zhvillimin profesional të një sistemi të informacionit.

Infrastruktura e Sistemit te Informacionit (O): 6 ECTS

Qëllimi i lëndës është që të informohen studentët me infrastrukturën e informacionit të ditëve të sotme. Kjo infrastrukturë mund të shikohet dhe analizohet nga studentët në kontekstin e perspektivës ekonomike, sociale, biznesore dhe teknologjike. Studentët duhet të fitojnë njohuri se si menaxhohet krijimi i një infrastrukture, informacioni dhe si do të ndikojë teknologjia e informacionit në vitet e ardhshme.

Menaxhimi i Projekteve në Sistemin e Informacionit (O): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, të mësohet menaxhimi dhe kontrollimi i projekteve të sistemit të informacionit, në harmoni me qëllimet strategjike, organizative dhe brenda kufizimeve të arrijë të menaxhojë projektet ekipore me performancë më të lartë, në implementim e zgjidhjeve të sistemit të informacionit. Këtu do të përfshihen, zhvillimi, kontrollimi dhe ekzekutimi i planeve për të menaxhuar projektet e sistemit të informacionit.

Menaxhimi i Sigurisë se Sistemit te Informacionit (O): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, aftësimi i studentëve në menaxhimin e sigurisë së sistemit të informacionit, implementimin e politikave, proceseve, procedurave, strukturave organizative dhe funksionet softwerike dhe hardwerike me qëllim të menaxhimit sa më të mirë të sigurisë. Studentëve do t`u paraqiten modelet më të mira të menaxhimit

të sigurisë së informacionit, menaxhimit e integritetit dhe disponueshmërisë së sistemit të informacionit.

Menaxhimi Strategjik (Z): 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të përfitojnë njohuritë e nevojshme të koncepteve të menaxhimit strategjik dhe aplikimit të tyre në praktikë, për arritjen e qëllimeve afatgjata - strategjike të organizatës. Të analizojnë në detaje procesin e planifikimit strategjik të një biznesi nëpërmjet: vlerësimit të fuqive dhe dobësive; studimit dhe parashikimit të mjedisit të jashtëm të firmës; shanseve dhe kërcënimeve që i vijnë firmës nga mjedisi i jashtëm; hartimit të misionit, qëllimeve dhe objektivave të firmës; formulimit dhe zbatimit të planeve për arritjen e qëllimeve dhe objektivave; të zhvillojnë aftësitë personale të studentëve për marrjen e vendimeve; të bëjnë bashkërendimin e objektivave me vendimet e marra në kuadrin e strategjisë së firmës; t'i familjarizojnë studentët me metodat e drejtimit të bizneseve, duke ilustruar teorinë me shembuj konkretë, nga praktika e bizneseve botërore.

Qeverisja e Korporatave [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është studentët të njohohen me qeverisjet e korporatave, politikat dhe proceset qeverisëse të korporatave, të njohohen me politikat fiskale qeverisëse të Korporatave, të njohohen me faktorët kyç të qeverisjes së mirë të një korporate duke u bazuar në të hyrat, shpenzimet dhe çdo transaksion që kryhet brenda korporatave.

Kompetencat Ndërkulturore [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i këtij kursi është rritja e aftësisë së studentit për të punuar në një ambient me kultura të ndryshme. Kursi ka për qëllim edhe masterizimin e kulturave përfshirë racën, nacionalitetin edhe gjinitë. Në disa tema diskutohet edhe rëndësia e media sa i përket aspekteve kulturore. Të shohin interaksionin në rritje të kulturave të ndryshme dhe bashkëpunimi mes tyre në aspekte kulturore, të njohohen edhe me termat e globalizmit, migrimit, diversitetit të kulturave etj.

TEKNOLOGJI NË BIZNES - VITI I TRETË- SEMESTRI II

Menaxhimi i Burimeve të Informacionit (O): 7 ECTS

Qëllimet e lëndës Menaxhimi i Burimeve të Informacionit, janë në përgatitjen e studentëve që në të ardhmen, kur do të përballen me shumë burime të ndryshme të informacionit, t'i vetëvlersojnë këto burime, t'i verifikojnë dhe t'i menaxhojnë këto burime të informacionit me njohuritë e fituara gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve të kësaj lënde.

Shkrimi Akademik dhe Metodologjia e Hulumtimit (O): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët t'i studiojnë rregullat themelore që kanë të bëjnë me metodologjinë e hulumtimit shkencor dhe të shkrimit akademik. Qëllimi kryesor i studimit të kësaj lënde, është informimi shkencor dhe praktik dhe aftësimi teorik e praktik për metodologjinë hulumtuese dhe shkrimin e punimeve profesionale dhe shkencore; konkretisht për përcaktimin e temës së punimeve profesionale; mbledhjen e burimeve bibliografike, strukturën e punimeve profesionale dhe shkencore; për metodologjinë shkencore të citimit të burimeve bibliografike; shkruarjen e punimit; renditjen e burimeve bibliografike, përgatitjen teknike të punimit dhe aspekte të tjera metodologjike, që kanë të bëjnë me punimin.

Organizimi dhe Strategjia e Sistemeve të Informacionit (O): 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të profesionalizohen që nga faza e parë. Të aftësohen në organizmin dhe përpilimin e strategjive afatgjate dhe të suksesshme për një sistem të informacionit të mirëfilltë. Do të njohohen me teknikat dhe tiparet organizative dhe strategjike të një sistemi, do t'i njohin shumë detyra që duhen realizuar të arrijnë në një sistem adekuat për institucionin përkatës.

Politika dhe Rregullimi i Sistemeve të Informacionit (O): 6 ECTS

Edhe lënda, Politika dhe Rregullimit i Sistemeve të Informacionit, ka për qëllim që studentët të avancohen në fushat e politikave dhe çështjen e rregullimit të një sistemi

të informacionit sa më profesional, duke ua mundësuar studentëve njohjen e politikave më të mira botërore. Qëllim tjetër është që studentët vetë të arrijnë në rregullimin e sistemit të informacionit duke analizuar dhe kontrolluar në detaje të dhënat e sistemit gjegjësisht duke nxjerrë një sistem të fortë të informacionit.

Menaxhimi i Operacioneve (Z): 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentëve t`ju ofrohen njohuri hyrëse, mjaftë të kompletuara, të përmbledhura dhe të azhurnuara, lidhur me vendin dhe rolin e menaxhimit të operacioneve në menaxhimin efikas të bizneseve. Që studentët të fitojnë njohuri dhe të aftësohen për aplikimin praktik të kornizës teorike dhe profesionale që ka të bëjë me menaxhimin e operacioneve në bizneset bashkëkohore prodhuese dhe shërbyese.

Tregtia Elektronike [Z]: 4 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është studentët të njohohen me konceptet e duhura të disa modeleve bashkëkohore të zhvillimit të tregtisë elektronik: B2B, B2C, C2C, C2B. Do të njohohen me konceptet e tregtisë elektronike (E-commerce), e-marketing, e-banking, të njohohen me proceset biznesore të realizuara përmes teknologjisë së informacionit e veçanërisht përmes internetit ose në mënyrë elektronike.

Etike në TI [Z]: 4 ECTS

Qëllimet e kësaj lënde janë që studentët të fitojnë njohurit e konsiderueshme në etikën e Teknologjisë Informative. Të aftësohen në konceptet themelore të etikës, kodin standard të etikës në TI, zhvillimi e koncepteve të etikës, të aftësohen në hartimin dhe zbatimin e disa rregullave të kodit të etikës që janë bazë për TI, zgjidhjen e problemeve, konflikteve të interesit, ndershmërinë, paanësinë dhe komunikimin në proceset biznesore.

Punimi i diplomës dhe praktika [O]: 10 ECTS